

R E L A C I O N
PËR PROJEKTLIGJIN
PËR
DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË LIGJIN NR. 9863, DATË 28.1.2008 “PËR USHQIMIN”, I
NDRYSHUAR

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Qëllimi i këtij projektligji është përcaktimi i parimeve të përgjithshme në lidhje me forcimin e kontrollit gjatë të gjithë zinxhirit ushqimor, duke siguruar një nivel të lartë të mbrojtjes së shëndetit dhe interesave të konsumatorit.

Për këtë qëllim, ky projektligj, ka për objektiv të sigurojë bazën për të garantuar që çdo hallkë e zinxhirit ushqimor të jetë shumë e fortë për të arritur synimin që shëndeti i konsumatorit të jetë plotësisht i mbrojtur. Ky objektiv është i vlefshëm pavarësisht nga fakti nëse ushqimet prodhohen në Shqipëri apo importohen nga vende të tjera.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Sigurimi i një niveli të lartë të mbrojtjes së shëndetit të njerëzve dhe interesave të konsumatorit është një nga prioritetet kryesore në programin politik të qeverisë shqiptare. Një politikë efikase e sigurisë ushqimore duhet të njohë natyrën komplekse të prodhimit të këtyre ushqimeve si dhe vlerësimin e monitorimit të risqeve mbi shëndetin e njerëzve. Për këtë arsye Qeveria shqiptare ka patur dhe ka në vëmendjen e saj forcimin e kontrollit dhe të monitorimit të ushqimeve që prodhohen dhe tregtohen në tregun shqiptar të destinuar për konsum njerëzor si dhe të ushqimeve që përdoren për kafshë.

Ky projektligj nuk është parashikuar në Programin Analitik të Akteve që do të miratohen për vitin 2017 në PKIE, kapitulli 12 “Politikat e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë dhe Fitosanitetit”, si dhe Strategjia Ndërsektoriale për Zhvillimin Rural dhe Bujqësor 2014 – 2020.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Lëvizja e lirë e ushqimeve të sigurta dhe të shëndetshme është një aspekt thelbësor i tregut të brendshëm dhe kontribuon ndjeshëm në shëndetin, mirëqenien dhe në interesat ekonomike dhe sociale të konsumatorëve. Shembujt e viteve të fundit në Evropë si ajo e BSE (sëmundja e lopës së çmendur), gripi i shpendëve dhe dioksina, të cilat përbëjnë rrezik për shëndetin e popullatës por dhe shkaktojnë dëme nga

pikëpamja ekonomike tregtare, kanë treguar se zinxhiri i prodhimit ushqimor po bëhet gjithnjë e më kompleks.

Ky projektligj përmirëson disa dispozita të paqarta në ligjin aktual, nisur edhe nga praktika e krijuar dhe problemet e dala gjatë zbatimit të tij.

Ky projektligj është përqendruar kryesisht në përmirësimin e dispozitave lidhur me procesin e “analizës së riskut” dhe ndarjen e kompetencave ndërmjet Ministrisë dhe AKU-së në lidhje me këtë proces. Me qëllim që të reduktohet, eliminohet ose parandalohet një risk për shëndetin, tre komponentë ndërthuren në analizimin e riskut – vlerësimi i riskut, menaxhimi i riskut dhe komunikimi i riskut – që sigurojnë një metodologji për përcaktimin e masave efektive, proporcionale dhe qëllimit (ku duhet të arrihet) ose veprimeve të tjera për mbrojtjen e shëndetit. Me qëllim që këto të bëhen në baza shkencore në ligjin e ushqimit, vlerësimi i riskut do të bëhet në mënyrë të pavarur, objektive dhe transparente, në bazë të të dhënave dhe informacionit shkencor të vlefshëm.

Dispozitat lidhur me kontrollin zyrtar janë riformuluar dhe janë plotësuar me tre nene shtesë. Riformulimi sjell një përafrim më të mirë me *acquis communautaire* për sa i përket objektit të kontrollit, veprimtarive, teknikave dhe metodave të kontrollit. Riformulimet e neneve kanë synuar hedhjen e një hapi përpara në drejtim të legjislacionit evropian.

Më tej, janë riformuluar dhe grupuar në koherencë me njëra tjetrën dispozitat lidhur me instrumentet (masat) në dispozicion të AKU-së për sigurinë ushqimore. Këto masa janë gjithashtu riformuluar në përfaqje me ligjin e inspektimit dhe janë grupuar njëra pas tjetrës (në ligjin aktual ishin të shpërndara në krerë të ndryshëm dhe jo të plota) për të dhënë të plota hapat që duhen ndërmarrë gjatë marrjes së masave të kontrollit zyrtar.

Projektligji përmirëson dispozitat në lidhje me laboratorët e autorizuar të kontrollit zyrtar të ushqimeve duke përcaktuar si kusht, akreditimin e tyre nga organi kombëtar i akreditimit. Nga ana tjetër janë përmirësuar dispozitat në lidhje me qendrën kombëtare të referencës, ISUV, duke i dhënë edhe statusin e institucionit kërkimor shkencor. Rregullorja Evropiane 882/2004/EC përcakton që qendra e referencës duhet të kryej kërkime shkencore në fushën për të cilën ajo është referencë. Nga ana tjetër, ISUV duhet të përgatitet për hyrjen në rrjetin evropian të laboratorëve të referencës me hapjen e negociatave me BE-në.

Dispozitat lidhur me organizmin dhe funksionimin e AKU-së, janë riformuluar dhe qartësuar më tej. Ndryshime të rëndësishme janë ato në lidhje me rishikimin e dispozitave të cilat parashikojnë ngritjen dhe funksionimin e Bordit pranë AKU-së. Bordi i AKU-së, me përbërjen e dhënë në ligjin aktual, përbën një strukturë këshillimore inaktive. Projektligji ka përcaktuar një përbërje të re të Bordit duke përcaktuar kompetenca të qarta për të ushtruar përgjegjësinë, për të siguruar që AKU-ja kryen misionin dhe përmbush detyrat e ngarkuara nga ky ligj. Në këtë nen jashtë shtuar edhe detyrat dhe përgjegjësitë e bordit të AKU-së.

Në kuadër të reformës së derregullimit projektligji ka parashikuar heqjen e licencës së prodhimit primar si dhe të hapësirave të lëvizëshme dhe/ose të përkohëshme. Rregullimet e bëra me anë të këtij projektligji synojnë të pasqyrojnë, si në lidhje me statusin ashtu edhe me funksionet e AKU-së, konsolidimin e saj si autoriteti inspektues më i lartë në fushën e sigurisë ushqimore si dhe të gjithë hapësirës së fushëveprimit të Ministrisë.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji propozohet në mbështetje të neneve, 78, 81 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Ky projektligj përafrohet në mënyrë të pjesshme Rregulloren 178/2002/EC të Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 28 janar 2002 mbi parimet e përgjithshme dhe kërkesat e ligjit të ushqimit, krijimi i Autoritetit Evropian të Sigurisë Ushqimore dhe nxjerrja e procedurave të çështjet e sigurisë ushqimore dhe Rregulloren 882/2004/EC të Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 29 prill 2004 mbi kontrollin zyrtar të kryer për të siguruar verifikimin e përputhshmërisë me ligjin e ushqimit dhe ushqimit për kafshë, shëndetin e kafshëve dhe rregullat për mirëqenien e kafshëve.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Për arritjen e qëllimeve të lartpërmendura, projektligji propozon ndryshimin e disa neneve të ligjit aktual si dhe propozon shtimin e disa neneve apo paragrafëve të reja, si më poshtë:

Në nenin 1 bëhen ndryshime në emërtime.

Në nenin 2 bëhen shtesa dhe ndryshime në nenin 3 “Përkufizime” të ligjit. Në këtë nen janë shtuar 21 përkufizime të reja.

Neni 3 ka ndryshuar nenin 4 duke shtuar konceptin e analizës së riskut.

Neni 4 shton nenin 4/1 pas nenit 4 për vlerësimin e riskut dhe përcakton që vlerësimi i riskut bëhet në mënyrë të pavarur, objektive dhe transparente nga Komiteti Shkencor i Vlerësimit të Riskut dhe panelet shkencore.

Neni 5 ndryshon nenin 5 në lidhje me komunikimin e riskut dhe ngarkon ministrinë për komunikimin e riskut me konsumatorin.

Neni 6 ndryshon nenin 6 në lidhje me menaxhimin e riskut duke ndarë qartë detyrat midis ministrisë dhe AKU-së në lidhje me këtë proces.

Neni 7 ndryshon nenin 8 në lidhje me parimet e transparencës duke përcaktuar qartë se informimi i konsumatorit duhet të përfshijë identifikimin e ushqimit ose ushqimit për kafshë, rrezikun që ai mund të paraqesë, si dhe masat e marra ose që mund të merren për të parandaluar, zvogëluar ose zhdukur këtë rrezik.

Neni 8 ndryshon nenin 16 në lidhje me kontrollin e ushqimeve në pikat e inspektimit kufitar duke përcaktuar se ky kontroll kryhet nga inspektori i PIK, masat që duhet të marrë në rast dyshimi ose mospërputhje me kërkesat e detyrueshme sipas legjislacionit ushqimor apo atij veterinar si dhe bashkëpunimin me autoritetet doganore.

Neni 9 shfuqizon nenin 17.

Neni 10 ndryshon nenin 18 në lidhje me dokumentacionin e importit dhe eksportit, njohjen e tyre si dhe procedurën në rast dyshimi.

Neni 11 ndryshon nenin 19 në lidhje me licencimin dhe rastet e pezullimit dhe/ose revokimit të licencës së operatorëve dhe stabilimenteve të ushqimit. Gjithashtu, nuk përfshin në procesin e licencimit kategoritë e prodhimit primar si dhe të hapësirave të lëvizëshme dhe/ose të përkohëshme.

Neni 12 ndryshon nenin 20 në lidhje me identifikimin e operatorëve të biznesit ushqimor. Çdo stabiliment i licencuar identifikohet me një numër unik identifikimi për qëllimet e sigurisë ushqimore dhe e shënon atë në etiketë, në shenjat e tjera të baras vlefshme dhe në dokumentacionin shoqërues të ushqimit që prodhojnë apo përpunojnë.

Neni 13 ndryshon nenin 25 në lidhje me kërkesat për gjurmueshmërinë e ushqimeve. Ky nen përcakton informacionin e nevojshëm për gjurmueshmërinë si dhe ruajtjen e këtyre të dhënave jo më pak se 3 vjet.

Neni 14 ndryshon pikën 7 të nenit 26 duke saktësuar se cilët operatorë të biznesit ushqimor mund të përfitojnë nga përjashtimi për zbatimin e sistemit të vetëkontrollit.

Neni 15 shfuqizon pikën 2 të nenit 37.

Neni 16 ndryshon nenin 38 në lidhje me kontrollin zyrtar të ushqimit. Ky nen përcakton kryerjen e këtij kontrolli nga inspektorët e AKU-së në të gjitha fazat e prodhimit, përpunimit dhe shpërndarjes, me qëllim verifikimin e përputhshmërisë me kërkesat e detyrueshme të legjislacionit ushqimor.

Neni 17 shfuqizon nenin 39.

Neni 18 ndryshon nenin 40 në lidhje me planifikimin dhe procedurat e kontrollit zyrtar. Kontrolli zyrtar kryhet në përputhje me rregullat e parashikuara në ligjin e inspektimit, rregullisht në bazë të vlerësimit të riskut, pa njoftim paraprak.

Neni 19 ndryshon nenin 41 në lidhje me veprimtaritë, metodat dhe teknikat e kontrollit.

Neni 20 ndryshon nenin 43 në lidhje me masat e posaçme urgjente në rast dyshimi të arsyeshëm për shkelje të kërkesave të legjislacionit ushqimor dhe është e

nevojshme kryerja e verifikimeve të mëtejshme dokumentare apo marrja e mostrave për analizë deri në marrjen e një vendimi përfundimtar.

Neni 21 shton pas nenit 43, nenin 43/1 në lidhje me masat dhe sanksionet e posaçme administrative për operatorët e biznesit ushqimor.

Neni 22 shton pas nenit 43/1, nenin 43/2 në lidhje me masat e posaçme për trajtimin e ushqimit të pasigurt, nëse vlerësohet se nuk plotëson kërkesat e sigurisë dhe higjienës.

Neni 23 shton pas nenit 43/2, nenin 43/3 në lidhje me planin e monitorimit të mbetjeve, përgatitjen dhe mbikëqyrjen e zbatimit të tij nga AKU dhe laboratorët e autorizuar.

Neni 24 ka shfuqizuar germën c) në pikën 1 dhe në pikën 4, hiqet fjala “për të lëshuar certifikatë ndërkombëtare” të nenit 45.

Neni 25 pas pikës 3 shton pikë 3.1 në nenin 46 në lidhje me laboratorët e referencës, përcaktimin e laboratorëve të tjerë të akredituar. Gjithashtu, në këtë nen është shtuar dispozita në lidhje me aktivitetin kërkimor shkencor në fushën e ushqimit dhe ushqimit për kafshë që do të kryhet nga ISUV.

Neni 26 ndryshon nenin 47 në lidhje me planin e përgjithshëm për menaxhimin e krizave.

Neni 27 ndryshon nenin 48 në lidhje me masat e përgjithshme për garantimin e sigurisë ushqimore kur çmohet se një ushqim apo ushqim për kafshë paraqet një rrezik serioz për shëndetin e njerëzve, shëndetin e kafshëve apo për mjedisin dhe se një rrezik i tillë nuk mund të parandalohet, reduktohet apo eliminohet.

Neni 28 ndryshon nenin 50 ku në pikën 2, pas shkronjës dh) shtohet shkronja e) dhe pas pikës 2 shtohet pika 3 në lidhje me sigurinë e ushqimit për kafshë.

Neni 29 ndryshon nenin 51 në lidhje me importin, eksportin dhe kontrollin e ushqimit për kafshë.

Neni 30 ndryshon nenin 57 në lidhje me kontrollin zyrtar të ushqimit për kafshë.

Neni 31 shfuqizon nenin 58.

Neni 32 ndryshon nenin 59 në lidhje me zbatimin e dispozitave për laboratorët e autorizuar të kontrollit dhe të referencës.

Neni 33 shfuqizon pikat 3 dhe 6 të nenit 61.

Neni 34 ndryshon nenin 62 në lidhje me fushën e veprimtarisë së Autoritetit Kombëtar të Ushqimit.

Neni 35 shfuqizon nenin 63

Neni 36 ndryshon nenin 64 në lidhje me Bordin.

Neni 37 ndryshon nenin 66 në lidhje me Komitetin Shkencor të Vlerësimit të Riskut dhe panelet shkencore.

Neni 38 shton pikën 6 në nenin 72 në lidhje me akreditimin.

Neni 39 ka të bëjë me hyrjen në fuqi.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Në përgatitjen e këtij projektligji kanë kontribuar një grup ekspertësh nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural si ministria përgjegjëse për sigurinë ushqimore.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Zbatimi i këtij projektligji ka efekte financiare për buxhetin e shtetit.

Shtesa nga Buxheti i Shtetit me nivel të kostove shtesë vjetore është 6.722 mijë lekë dhe në nivel mujor 560 mijë lekë, kjo për rreth 24 punonjës shkencor të ISUV, që mbajnë gradën shkencore “Doktor”. Përfitimi i kësaj shtesë kërkon ndërhyrje në VKM nr. 187, datë 15.03.2017 “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e presidentit, kuvendit, komisionit qendror të zgjedhjeve, gjykatën e lartë, prokurorinë e përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e prefektit”, pasi punonjësit shkencor janë deri në nivelet specialist me titull e grada. Efekti financiar do të parashikohet në buxhetin e vitit 2019, duke reduktuar kosto të panevojshme dhe mundësimin e shtesave të nevojshme.

Projektligji është ripunuar bazuar në mendimet e ardhura nga ministrinë e linjës dhe grupet e interesit si dhe për Institutin e Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë krahas përcaktimit të laboratorëve të tij si qendër reference është shtuar edhe kryerja e veprimtarisë kërkimore shkencore, argumentuar në Kreun III të këtij Relacioni.

Projektligji është dërguar për mendim në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve dhe Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme.

Ministria e Arsimit dhe Sporteve është shprehur dakord.

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme është shprehur dakord.

Mendimet e dhëna nga Ministria e Financës dhe Ekonomisë janë pasqyruar pjesërisht, si më poshtë:

1. Në lidhje me sjelljen në vëmendje se kërkimi shkencor rregullohet me ligjin nr.80/2015 sqarojmë se projektligji është dërguar për mendim në Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve e cila është shprehur dakord.
2. Në lidhje me sjelljen në vëmendje se bordi i AKU-së nuk mund të kryej funksione të lidhura me menaxhimin administrativo – financiar sqarojmë se në projekt akt nuk i është dhënë një funksion i tillë.
3. Sugjerimi për përcaktimin e afatit maksimal të lejuar për kryerjen e procedurave nga inspektori në PIK nuk pasqyrohet sepse ngarkesat e importuara janë të llojeve dhe madhësive të ndryshme dhe procesi i kontrollit, me të gjithë elementët përbërës, varet prej tyre duke e bërë atë të ndryshëm për ngarkesa të ndryshme. Gjithashtu, në raste të caktuar kur është i nevojshëm marrja e mostrave dhe analizimi i tyre përpara marrjes së vendimit, ky kontroll kushtëzohet edhe nga koha e nevojshme për kryerjen e analizave. Legjislacioni europian në fushën e sigurisë ushqimore, mbi të cilën është përgatitur projektligji, nuk parashikon kohë për kryerjen e kontrollit zyrtar.
4. Për sugjerimin që Pikat e Inspektimit Kufitar për produktet ushqimore të jenë të njëjtat me pikat doganore sqarojmë se Pikat e Inspektimit Kufitar për produktet ushqimore përfshihen në Pikat e Kalimit Kufitar të Republikës së Shqipërisë por kontrolli i ushqimeve dhe ushqimeve për kafshë nuk mund të kryhet në të gjitha Pikat e Kalimit Kufitar pasi kërkojnë infrastrukturë të nevojshme për kryerjen e kontrollit. Gjithashtu, kërkojnë edhe specifikim të tyre bazuar në tipin e ngarkesës.
5. Sugjerimi për shtimin e nenit për “single window” në këtë projektligj e konsiderojmë si jashtë fushës së veprimit të këtij projektligji dhe për më tepër ky projektligj nuk e pengon ngritjen e tij.
6. Sugjerimi për të hequr periudhën e tranzicionit për akreditimin e laboratorëve nuk është pasqyruar pasi heqja e kësaj periudhe do të penalizonte të gjithë rrjetin laboratorik në fushën e sigurisë ushqimore duke dëmtuar rëndë kontrollin e ushqimeve dhe ushqimeve për kafshë. Në këtë rast duhet marrë parasysh që në Shqipëri nuk ka asnjë laborator shtetëror apo privat të akredituar që të kryej analiza të domosdoshme dhe të mjaftueshme për të garantuar sigurinë ushqimore në kuadër të kontrollit zyrtar.

Mendimet e dhëna nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale janë pasqyruar pjesërisht, si më poshtë:

1. Sugjerimi për shtimin në nenin 12, pika 3 të projektligjit të fjalisë “Në rastin e kripës së jodizuar këto të dhëna ti jepen menjëherë ministrisë përgjegjëse për

shëndetësinë dhe inspektoriatit përgjegjës për shëndetësinë” nuk është pasqyruar pasi kripa e jodizuar rregullohet me ligj të veçantë dhe dispozita e sugjeruar mund të pasqyrohet në atë ligj.

2. Për sugjerimin e përfaqësimit të ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë me dy anëtar në bordin e AKU-së, përfaqësim i barabartë me ministrinë përgjegjëse për bujqësinë, sqarojmë se ky sugjerim nuk është pasqyruar pasi kjo e fundit është përgjegjëse për garantimin e sigurisë ushqimore në vend dhe si i tillë duhet të ketë përfaqësim më të madh në bord.

Mendimet e dhëna nga Ministria e Drejtësisë janë pasqyruar pjesërisht, si më poshtë:

1. Sugjerimi që në nenin 33 (aktualisht neni 34 i projektligjit) të projektligjit të përcaktohet legjislacioni i zbatueshëm për rregullimin e marrëdhënieve të punës së punonjësve joinspektor në AKU nuk është pasqyruar pasi këto marrëdhënie rregullohen me akte të tjera ligjore.

Mendimet e dhëna nga Departamenti i Administratës Publike janë pasqyruar pjesërisht, si më poshtë:

1. Për sugjerimin për heqjen e pikës 1 dhe 6 të nenit 24 (aktualisht neni 25 i projektligjit) me arsyetimin se në bazë të ligjit 90/2012 institucionet ngrihen me vendim të Këshillit të Ministrave sqarojmë se ky projekt ligj nuk krijon Institutin e Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë por këtij instituti, krahas detyrave të tjera që kryhen, i jepet vetëm statusi si qendër kërkimore shkencore në fushën e ushqimit dhe ushqimit për kafshë.
2. Në lidhje me sugjerimin që krijimi, organizimi dhe fusha e veprimit të AKU të mos jetë pjesë e ligjit të ushqimit dhe për këtë qëllim nga ligji të shfuqizohet kreu XV dhe shkronja “h” e nenit 1 sqarojmë se ky sugjerim do të kihet parasysh në një moment tjetër kur ligji i ushqimit do të hartohet i ri. Në fazën aktuale gjykojmë se pasqyrimi i këtij sugjerimi do të sillte probleme në zbatimin e tij.

Gjithashtu, sugjerimi i zëvendësimit ku përmendet specifikisht në ligj, të shprehjeve “Autoriteti Kombëtar i Ushqimit” apo “AKU”, “Institutin e Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë”, me termat “institucioni përgjegjës...” nuk është pasqyruar për shkak të numrit të madh institucioneve përgjegjëse (katër) që përfshihen në kontrollin dhe analizimin e produkteve ushqimore. Zëvendësimi do ta bënte të palexueshëm ligjin.

MINISTRI

Niko Peleshi